



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 908/2024
Datë: 27 gusht 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 19 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.06/2019 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 27 gusht 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Z. Petrit Kryeziu, prokuror në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prizren, caktohet ushtrues i detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren.
2. Z. Petrit Kryeziu do të ushtrojë këtë pozitë nga data 27 gusht 2024, deri në emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren.
3. Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, z. Petrit Kryeziu, është i obliguar të ushtroj kompetencat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me legjislacionin në fuqi.
4. Z. Kryeziu ka të drejtë në benificionet që dalin nga ushtrimi i funksionit të ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren.
5. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Petrit Kryeziu;
- Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;
- Sekretariatit dhe Dosjes së prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.